



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V_192_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_206_05_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_206_05_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 18.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Jusuf Maliqi (shifra e konsumatorit DPR – 90037340) nga Besiana, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 04.05.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.04.2009, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 08.05.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka bërë kontrollimin e pikës matëse, gjatë kontrollimit ky ekip k dyshuar në pasaktësinë e njehsorit meqenëse xhami i njehsorit është vërejtur i krisur dhe kanë rekomanduar që ky njehsor të dërgohet në qendrën e kalibrimit.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0142780 të datës 08.05.2008
- Me datë 14.07.2008 punëtorët e KEK-ut kanë bërë ndërrimin e njehsorit të konsumatorit nr. 17720548 dhe ka vendosur njehsorin nr. 17692654.
Provë: Vërtetimi për ndërrimin e njehsorit elektrik
- Me datë 29.11.2008 Qendra e Kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit të konsumatorit nr. 177720548, ku gjatë kontrollimit është konstatuar se për rreth qelqit nga ana e majtë është futur shiriti filmik, si dhe në brendësi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.
Provë: Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 3/29 të datës 29.11.2008

- Me datë 16.03.2009 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07407 të datës 3,006.44 €.
Provë: Fatura DPR09HP07407 e datës 16.03.2009
- Me datë 12.04.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e ekipit të kontrollës nr. 010995 dhe procesverbalin e kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 22.04.2009
- Me datë 04.05.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 12.05.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 12.05.2009
- Me datë 18.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_206_05_09
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_206_05_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Ve

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

